

Nr. Prot. 026/B/18

Dt; 26.04.2018

VENDIM Nr. 1182

Për

Fillimin e Procesit të Konsultimit Publik

Për

Draft Rregulloren për "Shfrytëzimin e Brezeve të Radio Frekuencave për të cilat nuk kërkohet Autorizim Individual dhe Kushtet Teknike të Përdorimit të Radio Pajisjeve në këto breze"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike, të nenit 10, paragrafët 4), neni 46 paragrafët 1) dhe 2. 1), neni 47 paragraf 1, neni 54 paragrafi 2.3) dhe 2.8), neni 82 paragrafi 1) dhe 2) dhe neni 98 dhe neni 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (Ref. Nr.Prot.054/B/17) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si; ARKEP ose Autoriteti*), Bordi Drejtues i Autoritetit në përbërje prej:

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar
- 2) z. Nijazi Ademaj Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar dhe
- 5) z. Shqiprim Pula Anëtar

në mbledhjen e 22-të me radhë të mbajtur me dt. 18.10.2017, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Departamenti i Menaxhimit të Frekuencave (DMF) unanimisht morri këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik për Draft Rregulloren për Shfrytëzimin e brezeve të radio frekuencave për të cilat nuk kërkohet Autorizim Individual dhe Kushtet Teknike të Përdorimit të radio frekuencave në këto breze.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë **26 Prill 2018** dhe përfundon më datë **25 Maj 2018**.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: *“Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”* Poashtu, paragrafi 12 i neni 10 të Ligjit përcakton se: *“Autoriteti menaxhon resurset e fundme – spektrin e radio – frekuencave.”*

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikojë ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 26/04/2018

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Operatorëve të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike
- Departamentit për Menaxhimin e Frekuencave, ARKEP
- Departamenti ligjor, ARKEP
- Arkivit, ARKEP